

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,  
SEZONI 2023/2024  
(java e gjashtë, deri më 11.02.2024)**

**TË DHËNA JAVORE**


Gjatë javës së gjashtë të vitit 2024 (nga 05-11.02.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 1.875 (I=102,1/100.000) të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 13,4% më pak krahasuar me javën e kaluar (n=1.653).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=700) është regjistruar një rritje prej 2,7 herë, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit (n=2.654) është regjistruar një rënie prej 29,3%. (Grafiku 1)

Gjatë javës së gjashtë të vitit 2024, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 56 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. 12 raste kanë rezultuar pozitive për Influenza, 11 Influenza A(H1)pdm09 dhe 1 Influenza A e pasubtipizuar. Është regjistruar 1 rast me COVID-19.

Incidenca e raportuar është mbi kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=30,6/100.000) (Grafiku 1).

*Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024*




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 1.139 persona, nga 0-4 vjet – 147, tek grupmosha nga 5-14 – 424 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 165 persona. Incidencë më e lartë (197,4/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 5-14 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë raportuar nga 29 QShP/NjR: Kavadar - 332, Shkup – 209, Manastir – 180, Strumicë - 179 ndërsa në të tjerat numri i rasteve të raportuara është më pak se 150.

Nga njësitë e raportimit që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave në 5 është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 11 është regjistruar aktivitet sezonal i virusit të gripit, në 10 mesatar, ndërsa në 1 i lartë dhe në 2 shumë i lartë (*Hartogrami 1*).

**Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, jave e gjashtë 2024**



Gjatë kësaj jave është regjistruar një rast i vdekjes si pasojë e gripit, person në moshë 65 vjet nga Shkupi, që ka qenë i shtruar në KU të Pulmologjisë dhe KSIGJF, me komorbiditete dhe që nuk ka qenë i vaksinuar kundër gripit sezonal. Tek i ndjeri është vërtetuar Influenza A – e pasubtipizuar.


### **MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - Të dhëna kumulative**

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 10.537 (I=573,7/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=6.516) numri i rasteve të regjistruara është rritur për 61,7%,ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit (n=10.490) është regjistruar një rritje prej 0,4%.


Raste janë raportuar nga gjithsej 31 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (n=1.487) është regjistruar në QSHP Shkup ndërsa incidencë më e lartë kumulative (5.880,2/100.000) është regjistruar në Dibër.

Grafiku 2. Shpërndarja sipas QShP/NjR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 6.070 (57,6%), ndërsa incidencë më e lartë (1.470,1/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=1.419).


Grafiku 3. Shpërndarja sipas grupmoshës dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 1,9%
- nëntor – 268 raste ose 2,5%
- dhjetor – 829 raste ose 7,9%
- janar – 5.176 raste ose 54,2%
- shkurt – 3.528 raste ose 33,5%

Grafiku 4. Shpërndarja sipas muajve, sezoni 2023/2024



Deri më tani gjatë këtij sezoni janë regjistruar 8 raste të vdekjes si pasojë e gripit, nga Shtipi, Kumanova, Negotina, Gostivari, Demir Hisari dhe Shkupi, 5 të grupmohës nga 15-64 dhe 4 mbi 65 vjet, të gjithë të hospitalizuar, me komorbiditete dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal. Tek 8 raste është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, ndërsa tek 1 Influenza A – e pasubtipizuar.

#### **MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative**

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e gjashtë, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 749 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast janë detektuar 122 raste pozitive, 103 Influenza A(H1)pdm09, 9 Influenza A(H3) dhe 9 Influenza A – e pasubtipizuar dhe 1 Influenza B.

Janë regjistruar edhe 12 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 29 raste me Virus Respirator Sincial (RSV).

#### **MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)**

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së gjashtë janë raportuar gjithsej 55 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve - Shkup (n=20; 36,6%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=18; 43,6%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 214, me 1 rast në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 25,7% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 60,0% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet. Gjatë kësaj jave është regjistruar edhe një rast i vdekjes, person me komorbiditete, në SPQ 8 Shtatori- Shkup. Personi i ndjerë i përkiste grupmoshës mbi 65 vjet, nga Shkupi.

Kumulativisht gjatë javës së gjashtë për analizë laboratorike kanë arritur 35 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në 35 mostrat e analizuara tek 5 është vërtetuar prani e virusit të gripit Influenza A(H1)pdm09, në 1 Influenza A e pasubtipizuar. Në një është vërtetuar COVID-19, ndërsa në 4 mostra virusi sincicial respirator.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 813 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (n=278; 34,2%) janë raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve Shkup. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=394; 48,5%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 3.759, nga të cilët 36 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 21,6% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 41,1% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 9 raste të vdekjes, që i përkasin grupmoshës 30-64 vjet dhe mbi 65 vjet, me komorbiditete me Influenza A(H1)pdm09 dhe Influenza A e pasubtipizuar, ndërsa një me SARS-CoV-2.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 442 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në 69 mostra është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, në 6 Influenza A(H3), 2 Influenza A e pasubtipizuar dhe në 2 Influenza B/Victoria dhe në 1 Influenza B e papërcaktuar. Janë regjistruar 28 raste pozitive me COVID-19.

Nga mostrat SARI, 327 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 110 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit. Në 3 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e Influenza A(H1)pdm09 dhe SARS-CoV-2.

## **MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE**

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e gjashtë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë në ISHP kanë arritur 1.193 materiale, që janë testuar për prani të virusit të influencës dhe SARS-CoV-2.


Janë zbuluar 202 raste me Influenza:

- Influenza A – 198 (98,0%)
  - Influenza A(H1)pdm09 – 172 (86,9%)
  - Influenza A(H3) – 15 (7,6%)
  - Influenza A – e pasubtipizuar - 11 (5,5%)
- Influenza B – 4 (2,0%)
  - Influenza B/Victoria – 2 (50,0%)
  - Influenza B – e papërcaktuar – 2 (50,0%)

Janë regjistruar 40 raste pozitive me SARS-CoV-2, 141 me (RSV) dhe 13 me viruse të tjerë respiratorë. Nga rastet me Influenza dhe COVID-19, tek 6 raste është vërtetuar infeksion i dyfishtë (“flurona”).

Janë regjistruar 137 raste pozitive me (RSV) dhe 13 me viruse respiratore të tjera.

**Grafiku 5.** Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip, RMV, 2023/2024



### **KOMENT EPIDEMIOLOGJIK**

Vihet re një rritje e numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili është mbi kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit tregojnë aktivitet të gjerë të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një përhapje rajonale gjeografike intensitet mesatar të virusit të gripit.

### **VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL**

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)

- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk).

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti janë vaknuar gjithsej 59.100 persona nga kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.594 persona.

Deri në javën e gjashtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 61.694 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

## **RAJONI EVROPIAN**

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e pestë të vitit 2024 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 25 nga 31 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit po stabilizohet, aktiviteti i COVID-19 në 6 javët e fundit ka filluar të bjerë.
- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV në 7 javët e fundit kanë shënuar rënie.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza A (97%) - A(H1)pdm09 (71%) dhe A(H3) (29%).
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëqyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është rritur në 30% krahasuar me 28% një javë më parë. Pozitiviteti mesatar ishte 6–66%.
- SARS-CoV-2 është në 5% krahasuar me 5% javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar i vendit ishte 4% (shtrirja: 0–17%).
- RSV ishte 12% krahasuar me 15% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit ishte 11% (shtrirja: 0-50%).

Nga vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 2 vende ka raportuar për intensitet shumë të lartë, 7 për të lartë, 20 kanë raportuar intensitet mesatar, 6 të ulët dhe të tjerët raportuar intensitet bazë.

Nga vendet që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 29 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 1 - rajonale, 2 - sporadike, 2 - lokale.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive**  
**Instituti i Shëndetit Publik**